

ZHENI GJERGJI



Datëlindja: 4.7.1971

Vendlindja: Elbasan

E-mail: Zheni.Gjergji@parlament.al

Jetëshkrimi:

Është diplomuar në degën e mjekësisë së përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës dhe më pas studimet master në nefrologji në Fakultetin e Mjekësisë. Mban titullin akademik “profesore e asociuar”.

Ka një certifikatë mirënjohjeje në kuadër të 100-vjetorit të pavarësisë, akorduar nga Ministria e Shëndetësisë me motivacionin “Për kontributin e shquar ndër vite për mbrojtjen e shëndetit të popullatës, për përgatitjen e lartë profesionale si dhe përkushtimin e admirueshëm qytetar, human dhe shoqëror”.

Karrierën profesionale e ka filluar si mjeke familje pranë DISKSH-së Elbasan. Ka punuar si mjeke nefrologe në qendrën spitalore “Xhaferr Kongoli” në Elbasan. Ka një karrierë akademike si pedagoge e brendshme dhe e jashtme. Është autore e disa botimeve shkencore. Është e specializuar për hemodializë në qendrën spitalore të Universitetit të Ankarasë, Turqi.